



Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministrastvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development



**“VLERËSIMI I PASOJAVE DHE SFIDAVE NGA  
COVID-19 NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK  
RAJONAL ME THEKS NË ZHVILLIMIN E  
BIZNESEVE MIKRO DHE TË VOGLA NË  
RAJONIN QENDËR”**

Implementuar nga

Prishtinë,  
Dhjetor 2020



## Përmbajtje

Lista e Figurave .....	2
1.Hyrje .....	4
2.Përshkrimi i situatës pandemike në Kosovë .....	4
2.1.Ekonomia e Kosovës dhe impakti i COVID-19 .....	5
2.2.Masat për rimëkëmbje ekonomike .....	6
3.Qëllimi i Hulumtimit.....	7
4.Metodologjia .....	7
5.Ndikimi i COVID-19 në Bizneset e Komunave të Rajonit së Prishtinës .....	9
5.1.Ndikimi i COVID-19 në fuqinë punëtore.....	19
6.Paketat Stimuluese dhe Preferencat e Bizneseve .....	21
7.Përfundim .....	28
8.Rekomandime .....	29
Referencat .....	31

## Lista e Figurave

Figura 1. <a href="http://www.kosova.health">www.kosova.health</a> .....	5
Figura 2. Agjensioni i Statistikave të Kosovës “Vjetari Statistikor I Republikës së Kosovës 2020” .....	5
Figura 3. Qyteti ku ndodhet biznesi.....	9
Figura 4. Cila është veprimtaria kryesore e ndërmarrjes (Mund të përcaktohet vetëm një përgjigje): Nëse biznesi ka më shumë se një veprimtari atëherë shkruaj vetëm veprimtarinë kryesore. ....	10
Figura 5. Ju lutem vlerësoni ndikimin aktual të Koronavirusit në shitjet e biznesit tuaj deri në këtë moment, krahasuar me situatën normale para epidemisë? .....	11
Figura 6. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Zvogëlimi i kërkesave të klientëve] .....	12
Figura 7. A parashihni ndikim ekonomik negativ të situatës së krijuar nga Koronavirusi në biznesin tuaj në 6-12 muajt e ardhshëm? .....	13
A Figura 8. A keni anuluar ndonjë investim të planifikuar në infrastrukturën e kompanisë tuaj dhe / ose prodhim për shkak të shpërthimit të COVID-19? .....	13
Figura 9. Nëse keni kredi bankare a do të jeni në gjendje të paguani kështu e kredisë si rezultat i situatës së krijuar nga Koronavirusi? .....	14
Figura 10. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Furnizimi me lëndë të parë/shërbime] .....	15
Figura 11. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Kam humbur tregjet jashtë Kosovës] .....	16
Figura 12. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Pasiguria/Paftësia për të planifikuar biznesin].....	17
Figura 13. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Rrjedha e parasë (Paftësia për të paguar shpenzimet si pagat, qiraja, etj.)] .....	18
Figura 14. Si rezultat i klimës së krijuar nga Koronavirusi a e keni mbyllur biznesin ? .....	18
Figura 15. Nëse klima aktuale e biznesit si rezultat i Koronavirusit do të vazhdonte, sa kohë do të duhej që biznesi juaj të ketë ndikime të negative, siç është largimi i punonjësve nga puna? .....	19
Figura 16. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Qasja në fuqi punëtoresh (Mungesa e punëtorëve për shkak të sëmundjes, izolimit, kujdesit për fëmijët etj.)].....	20
Figura 17. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Pushime tatimor (lirimi nga tatimet për një kohë të caktuar)] .....	21
Figura 18. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Shtyrje e pagesës së tatimeve (Jo lirim nga pagesa e tatimeve)] .....	22

Figura 19. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Grante (pa kthim për biznese)].....	23
Figura 20. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Pagesa direkte për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve].....	24
Figura 21. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Aktivizimi i mjeteve të Trustit- Fondit Pensional].....	25
Figura 22. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Përdorimi i mjeteve të privatizimit].....	25
Figura 23. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Lirimi nga tatimet komunale per një afat të caktuar (6 deri në 12 muaj)] .....	26
Figura 24. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Përkrahja dhe inkurajimi i bankave që të japini kredi më normë zero të interesi.] .....	27

## 1.Hyrje

Covid-19 dhe përhapja pastaj në të gjithë botën ka detyruar shumë biznese në shumë industri të mbyllen, mbyllje e cila është e paprecedentë në gjithë botën. Këto masa, janë marrë me qëllim që të ruhet shëndeti I popullatës në Botë. Në këtë periudhe , shitësit me pakice dhe shumë biznese tjera kanë hasur në shumë vështirësi siç janë siguria, zingjiri i furnizimit, fuqia punëtore, rrjedhja e parasë, kërkesa e konsumatëroëve, dhe marketingu (Van Assche, 2020) (Donthu, 2020). Pandemia Covid-19 ka ndikuar që të ndërpritet furnizimi, sfida për furnizim me logjistikë, mungesë të burimeve kruesore, manipulime me çmime, vendimet e qeverive për kufizimin e industrive dhe tregjeve, nevojën për ridizejnimin e proceseve të ndryshme në shumë industry, dhe në fund rritjen e pesimizmit apo edhe sjelljen e konsumatorëve dhe erozioni i besimit në tregje financiare globale (Morgan, 2020). Kur pandemia në fillim goditi ekonominë botërore, qeveritë e ndryshme filluan të marrin masa për të ndaluar përhapjen e pandemisë. Gjatë këtij procesi, për të ulur ndikimin e pandemisë Covid-19 në biznese, shume qeveri propozuan paketa të ndryshme stimuluese për të ndaluar futjen e vendit në recession. Paketat stimuluese kanë dalluar në bazë të industrive dhe kontekstit të shtetit përkatës.

## 2.Përshkrimi i situatës pandemike në Kosovë

Virusi COVID-19 për herë të parë u shfaq në fund të vitit 2019 në Wuhan të Kinës e më pas u përhap në shumë vende të botës me një shpejtësi të madhe. Duke parë ritmin e përhapjes së këtij virusi më 12 Mars 2020 Organizata Botërore e Shëndetësisë identifikoi virusin COVID-19 si pandemi globale (Kluge, 2020). Rastet e para të infektimit me COVID-19 në Kosovë u paraqitën në Mars të 2020-tës. Si rrjedhojë e virusit dhe përhapjes së saj me ritme të shpejta qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë, ngjashëm me shumicën e vendeve të rajonit dhe botës, duke filluar nga data 13 Mars vendosi masa të cilat ndalonin lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe veprimtaritë biznesore, me përjashtim të sektorëve që konsideroheshin esencial si: dyqanet e produkteve ushqimore dhe barnatoret.

Kufizimi i udhëtimeve, mbyllja e plotë e kufijve dhe karantinimi ishin disa nga masat tjera që u ndërmorrën në Kosovë ahtu edhe si në shumë vende të botës si përgjigje ndaj parandalimit të pandemisë globale të virusit COVID-19.

Pasqyra e Situatës së Krijuar nga Virusi COVID-19 në Kosovë			
	Numri i të Infektuarëve	Numri i të Shëruarve	Numri i të Vdekurve
2020	12683	8788	488

Figura 1. [www.kosova.health](http://www.kosova.health)

Kosova me 1.8 milionë banorë ka regjistruar rastet e para me koronavirus më 13 mars dhe qysh atëherë ka konfirmuar gjithsej 12,683 raste pozitive. Nga ky numër 8,788 janë shëruar. Numri i personave të shtruar në klinikat infektive në spitale është i madh duke bërë që sistemi i brishtë shëndetësor të ketë mbingarkesa.

## 2.1. Ekonomia e Kosovës dhe impakti i COVID-19

Përhapja e Covid-19 dhe masat për ta parandaluar përhapjen e tij kanë pasur një ndikim dramatik në ekonominë e Kosovës dhe jo vetëm. Në Kosovë BPV vlerësohet të ketë rënë me -9.28% në TM2 2020 krahasuar me periudhën e njejtë të vitit paraprak ku BPV shënoi rritje për 4.13%. Sektorët më të prekur nga kufizimet e qeverisë ishin ata ku një pjesë relativisht e lartë e shpenzimeve të konsumatorëve përfshin kontaktin direkt fizik si; gastronomia, hoteleria, shërbimet rekreative dhe transporti.

	2019				2020	
	I	II	III	IV	I	II
<b>BPV-ja Nominale (Milionë EUR)</b>	1,421	1,824	1,967	1,877	1,438	1,636
<b>BPV-ja Reale</b>	1,404	1,790	1,952	1,860	1,440	1,655
<b>Norma reale e rritjes së BPV-së %</b>	4.24	4.13	4.38	3.94	1.31	(9.28)
<b>Eksperti i mallrave dhe shërbimeve (mijëra eur.)</b>	288,330	386,186	928,686	361,505	378,158	229,711
<b>Importi i mallrave dhe shërbimeve</b>	781,125	967,347	1,130,471	1,029,595	824,625	797,410

Figura 2. Agjensioni i Statistikave të Kosovës "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020"

## 2.2.Masat për rimëkëmbje ekonomike

Qeveria e Kosovës në Mars miratoj Pakon Emergjente Fiskale e cila përmban kryesisht masat afat-shkurta për adresimin e problemeve sociale të shkaktuar nga virusi COVID-19. Kjo pako përfshin masa të tilla si: pagesa të dyfishta për skemat sociale; mbulimi i pagave për punëtorët e sektorit privat me vlerë prej (41,000,000.00€); subvencione të qirasë për biznese deri në 50% të vlerës së qirasë (12,000,000,00€); shtesa për rrezik në paga të sektorit publik dhe privat; mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale me vlerë (8,000,000.00€) buxhet shtesë për komuna; pagesa shtesë për punëtorët e dyqaneve ushqimore dhe barnatore me vlerë (3,000,000.00€); kulturë; bujqësi; sigurim i likuiditetit financiar për ndërmarrje publike dhe private përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, në shumë (10,000.00€) deri (15,000,000.00€); si dhe shtyerja e afateve për pagesa tatiomore(Zyra e Kryeministrit, 2020).

Edhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili u miratua në Dhjetor të 2020, është pritur me padurim nga sektori privat, pasi që shumë biznese tashmë për një kohë të gjatë kanë qënë në vështirësi të mëdha financiare. Ndër propozimet e reja në kuadër të ligjit është themelimi i një granti prej 200 milionë eurosh, për ndihmë direkte financiare bizneseve të cilat kanë vështirësi të funksionimit si rezultat i ndikimit të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ligji ka paraparë që lënda e parë e cila prodhohet nga veprimtaritë biznesore në Kosovë, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit, të lirohet nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Përveç këtyre, në këtë ligj, parashihet që Fondi Kreditor Garantues i Kosovës, (FKGK) të autorizohet që të lëshojë garanci kreditorë me përqindje të mbulesës nga 50 deri në 80 përqind. Po ashtu, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, Ministria e Financave mund të shtyjë afatin e pagesës së tatimeve deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për bizneset që nuk arrijnë të bëjnë pagesën e deklaratës tatimore, nuk shqiptohet ndonjë ndëshkim, me kusht që pagesa të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2021. Ndërsa për Individët rimbursimi me 10 për qind të mjeteve që mund t'i tërheqin nga llogarite e tyre në Trustin pensional, ku nga Qeveria do të rimbursohen ata që kanë deri në 10 mijë euro në llogari, ndërsa ata mbi këtë shumë nuk rimbursohen (LIGJI NR. 07/L-016, 2020). Komuna e Prishtinës gjithashtu ka aprovuar Pakon e Masave Ekonomike për të përkrahur bizneset e Komunës së Prishtinës të cilët janë prekur nga pasojat e pandemisë COVID-19. Kjo pako është dizajnuar për ndërmarrjet e vogla me qarkullim vjetor deri 5,000.00€ dhe

ndërmarrjet e mesme me qarkullim vjetor deri 50,000.00€ e Komunës së Prishtinës që kanë pësuar dëme si rezultat i pandemisë COVID-19, në forme të granteve.

### 3. Qëllimi i Hulumfimit

Ky hulumtim ka për qëllim të paraqes një vlerësim të përgjithshëm të ndikimit të Covid19 në biznese, preferencat e bizneseve në lidhje me paketa të ndryshme stimuluese dhe vlerësimin e punës të instituconeve të ndryshme në menaxhimin e pandemisë në komunat e Rajonit të Prishtinës. Në këtë hulumtim, përveç ndikimit të Covid19 në biznese janë përfshirë. Ky hulumtim ka për qëllim që t'i shërbej komunat dhe institucionet tjera relevante e përfshira në studim një pasqyrë të qartë të ndikimit, preferencave dhe vlerësimit të bizneseve.

### 4. Metodologjia

Duke u bazuar në qëllimin e këtij hulumtimi, dhe të arrijë rrezultatet të qarta në lidhje me temën e hulumtuar, janë përfshirë komuna të gjitha komunat në rajonin e Prishtinës, dhe është arritur të ketë një gjithëpërfshirje e kënaqshme e industrive dhe firmave. Qëllimi në këtë kontekst, ka qenë të ofroj llojllojshmëri të mostrës përfshirëse dhe numrit të firmave të përfshira në studim. Numri i bizneseve që kanë participuar në këtë hulumtim janë gjithsej 129, të cilat biznese operojnë gjithsej në 15 industri dhe një në shërbime të tjera. Komunat e përfshira në këtë studim janë: Prishtina, Lipjani, Podujeva, Fushë Kosova, Drenasi, Obliliqi, Graçanica.

Qëllimi i këtij dizajnimi është të ofrojë një pasqyrë në disa aspekte: i) Ndikimi i Covid19 në biznese në Kosovë; ii) preferencat e bizneseve në lidhje me paketa të ndryshme stimuluese të Qeverisë. Duke u bazuar në temat e lartëcekura dhe qëllimin e hulumtimit, dhe mostrën e targetuar, si instrument i hulumtimit janë zgjedhur anketat. Dizajnimi i anketave dhe pyetjet janë definuar duke u bazuar në gjendjen aktuale të Covid19 në Kosovë.

Në temën e parë në lidhje me ndikimin e Covid-19 në biznese, anketa është fokusuar në tri aspekte kryesore: i) ndikimin e situatës pandemike në biznese i ndarë në disa nën kategori siç janë: ndikimin aktual dhe në të ardhmen i Covid-19 në biznese. Këto pyetje janë fokusuar në ndikimin e pandemisë në rritjen/zgogëlimin e biznesit, në fuqinë financiare të bizneseve për pagesën e obligimeve kreditore, investimet e planifikuara dhe në numrin e punëtorëve të larguar




nga puna dhe në fund numrin e bizneseve të mbyllura. Në fund, pyetjet janë fokusuar në ndikimin e pandemisë në të ardhmen.

Në grupin e dytë të pyetjeve në lidhje me ndikimin e Covid-19 në bizneset pyetjet janë lidhur në lidhje me ndikimin e pandemisë aspekte më specifike siç janë: në qasjen në fuqi punëtore-organizimn e brendshëm, zvogëlimin e kërkesave të klientëve-shtijet e biznesit, furnizimin me lëndë të parë dhe shërbime-funksionalizimin e biznesit në tërësi dhe aftësinë e biznesit për t'u përgjigjur kërkesave të konsumatorëve në lidhje me produktet dhe shërbimet e ofruara nga firma. Në kuadër të pyetjeve, pasiguria dhe paaftësia e biznesit për të planifikuar, ndikimi i Covid në eksportet e kompanisë ose më saktësisht në tregjet e jashtme që firma i ka humbur, ndërprerja e kontratave si rezultat i pandemisë, dhe rrjedhjen e parasë së firmës.


Pjesa e dytë e pyetjeve të pyetsorit ndërlidhet me paketat stimuluese apo edhe preferencat e bizneseve se cilat nga paketat stimuluese nga ana e qeverisë do t'i ndihmonin për ta ulur ndikimin negativ të Covid-19. Në këtë kontekst të pyetjeve, janë ndarë gjithsej disa kategori siç janë: i) Pushime tatimor-lirimi nga tatimet për një kohë të caktuar; ii) Grante; pa kthim për biznese; iii) Pagesa direkte për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve; iv) Aktivizimi i mjeteve të Trustit- Fondit Pensional; v) Grante- pa kthim për biznese; vi) Pagesa direkte për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve; vii) Përdorimi i mjeteve të privatizimit; viii) Lirimi nga tatimet komunale për një afat të caktuar (6 deri në 12 muaj);ix) Përkrahja dhe inkurajimi i bankave që të japin kredi më normë zero të interesit. Qëllimi i këtyre pyetjeve është të ofrojmë rekomandime për politika të institucioneve qendrore dhe lokale në lidhje me politika të ndryshme stimuluese për konunitetin e biznesit në përgjithësi.

## 5.Ndikimi i COVID-19 në Bizneset e Komunave të Rajonit së Prishtinës



**Figura 3.** Qyteti ku ndodhet biznesi


Zonat e targetuara ku është është zhvilluar procesi hulumtues përmes anketës, në formë elektronike, janë Komunat e Rajonit të Prishtinës. Pjesa dërmuese e bizneseve të cilët kanë plotësuar anketën kanë qënë nga Komuna e Prishtinës me 73%. Ndërsa komunat tjera kanë kontribuar me një përqindje më të vogël. Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Podujevës me 8% të anketuar; Drenasi me 4%; Lipijani me 3% dhe Obiliqi me Graçanicën me 2%.



**Figura 4. Cila është veprimtaria kryesore e ndërmarrjes (Mund të përcaktohet vetëm një përgjigje): Nëse biznesi ka më shumë se një veprimtari atëherë shkruaj vetëm veprimtarinë kryesore.**

Të gjitha industritë janë ndikuar nga kriza që ka shkaktuar COVID-19, me shkallë të ndryshme. Disa nga industritë e kanë përballuar më lehtë, ndërsa të tjerët përpiqen të kthehen në një "normale" që ndryshon vazhdimisht. Veprimtaritë biznesore me përqëndrim më të lartë në Komunitet e Rajonit të Prishtinës janë Tregtia me Pakicë me 14% dhe Hoteleria e Turizmi me 12.4%. Këto dy veprimtari konsiderohen edhe si më të goditurat nga masat e ndërmara nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së COVID 19. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës aktivitetet ekonomike që kanë shënuar rënie gjatë TM2 janë: ndërtimi (-47.08%); tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor (-24.4%); aktivitetet profesionale dhe administrative (-16.39%); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (-6.71%); si dhe bujqësia, pyjet dhe peshkimi (-1.74%) (Ministria e Financave, 2020). Kjo pandemi ndër të tjera ka imponuar sjellje të reja, bizneset kanë një mundësi për të përshpejtuar procesin e integritimit në tregtinë dixhitale, duke zgjeruar ofertat ekzistuese dhe duke krijuar linja të reja shërbimi, si shitësit me

pakicë që mblidhen për të siguruar shpërndarje "pa kontakt" dhe shërbime të marrjes nga ana e konsumatorëve. Ky përshejtim do t'i detyrojë organizatat të ristrukturojnë strategjitë e tyre dixhitale për të kapur mundësi të reja në treg.




**Figura 5.** Ju lutem vlerësoni ndikimin aktual të Koronavirusit në shitjet e biznesit tuaj deri në këtë moment, krahasuar me situatën normale para epidemisë?

Masat radikale restriktive për mbyllje totale të bizneseve, karantinim të njerëzve në shkallë të gjerë, mbyllja e kufinjëve dhe masat për distancimin shoqëror kanë shkaktuar një rënie të ndjeshme të shpenzimeve të konsumatorit. Kjo për arsye, se konsumatorët qëndrojnë në shtëpi dhe si rrjedhojë bizneset humbasin të ardhurat. **94,6%** e bizneseve kanë raportuar zvogëlim të shitjeve si rezultat i rënies së kërkesës nga klientët. Vetëm 1,6% e bizneseve kanë rritur shitjet, kurse 3,9% kanë mbetur të njëjta

Tek bizneset që kanë raportuar rënie të shitjeve, mesatarja e rënies së shitjeve është mbi **76%**

Perspektivat e bizneseve varen shumë nga vendimet e shpenzimeve që marrin familjet dhe bizneset. Për shkak se e ardhmja është e pasigurt, familjet dhe bizneset duhet të marrin këto vendime shpenzimesh bazuar në pritjet e tyre për të ardhmen. Këto vendime mund të varen, jo vetëm nga parashikimet e tyre për skenarët e mundshëm në të ardhmen, por edhe nga shkalla e pasigurisë rreth pritjeve të tyre dhe nga gjasat që gjërat të shkojnë keq. Matja dhe kuptimi i këtyre pritjeve është shumë e rëndësishme për politikëbërësit ekonomikë.

Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Zvogëlimi i kërkesave të klientëve]




**Figura 6. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Zvogëlimi i kërkesave të klientëve]**

Masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 kanë pasur pasoja direkte në rënien e kërkesave të klientëve për shërbime dhe produkte. 88.4% e të anketuarve kanë deklaruar se rënia e kërkesës ka ndikim negativ për biznesin.

Kufizimi i udhëtimeve dhe mbyllja e plotë e kufijve bënë që vizitat e diasporës së Kosovës të bien dukshëm gjatë këtij viti. Diaspora luan një rol shumë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, jo vetëm për shkak të dërgimit të remitencave për familjet e tyre, por edhe pse gjatë vizitave të tyre ata rrisin kërkesën për produkte dhe shpenzime dhe si rrjedhojë shpenzojnë shuma të konsiderueshme të parave, gjë e cila pasqyrohet në rritjen e aktivitetit ekonomik sektorëve si: gastronomia; hoteleria; derivatet; dyqanet ushqimore; shitjet me pakicë.


**A parashihni ndikim ekonomik negative të situatës së krijuar nga Koronavirusi në biznesin tuaj në 6-12 muajt e ardhshëm?**



**Figura 7.** A parashihni ndikim ekonomik negative të situatës së krijuar nga Koronavirusi në biznesin tuaj në 6-12 muajt e ardhshëm?

E ardhmja është e pasigurtë dhe është pothuajse e pamundëshme të bëhet një parashikim e vlerësim i saktë rreth ndikimit negativ të COVID-19 në ekonomi. Kjo pasiguri rreth së ardhmes ka rritur pritjet e realizimit të një skenari negativ për muajt e ardhshëm. 96% e të anketuarve kanë treguar pesimizëm për të ardhmen ekonomike.


**A keni anuluar ndonjë investim të planifikuar në infrastrukturën e kompanisë tuaj dhe / ose prodhim për shkak të shpërthimit të COVID-19?**



**Figura 8.** A keni anuluar ndonjë investim të planifikuar në infrastrukturën e kompanisë tuaj dhe / ose prodhim për shkak të shpërthimit të COVID-19?

Investimet e planifikuara në infrastrukturë dhe prodhim nga ana e bizneseve , me gjasë më të madhe do të anulohen, për shkak të disa faktorëve me rëndësi si: ndryshimi i parashikimeve vjetore; rënia e kërkesës dhe shkurtimi i të hyrave vjetore në biznese.

Pandemia ka ndikuar që bizneset t'i rikonsiderojnë vendimet e tyre për investime. 77.5% e bizneseve veçse raportojnë se kanë anuluar investimet e planifikuara në infrastrukturë apo në prodhim e shërbime.



**Figura 9.** Nëse keni kredi bankare a do të jeni në gjendje të paguani kështu e kredisë si rezultat i situatës së krijuar nga Koronavirusi?

Si faktorët e kërkesës ashtu edhe ato të ofertës kanë reflektuar në një performancë të dobët nga ana e kompanive. Nivelet e ulta të kërkesës bëjnë që kompanitë të hezitojnë të marrin kredi bankare ose të përdorin më tej bizneset e tyre në këtë kohë sepse nuk janë të sigurt nëse do të jenë në gjendje të ripaguajnë fondet në klimën aktuale ekonomike.

60% e respondentëve kanë deklaruar se kanë kredi bankare.

Faktorët që kanë kufizuar shfrytëzimin e mundësisë së ristrukturimit të kredisë dhe shtyerjeve të afateve për shlyerjen e kredisë bankare, në masë të gjërë nga ana e bizneseve ka qënë mosinformimi i duhur rreth procesit dhe vështirësitë në adaptimit e procedurave digjitale.

Shumica e bizneseve 71.3% do të ballafaqohen me shumë problem serioze për kthimin e kredisë, si rezultat i pandemisë. Për shkak të COVID-19 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nxori “Udhëzuesin për Ristrukturimin e Kredive”, me qëllim që kredimarrësit që kanë hasur në vështirësi financiare të kenë mundësi që ti përmbushin detyrimet e parapara me kontratë dhe të zhvillojnë aktivitetin e tyre biznesor. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), vendimi i BQK-së për t’i shtyer pagesat e kredisë, që u shfrytëzua nga më shumë se 50 përqind e gjithsej kredive bankare kanë zbutur ndikimin negative tek huamarrësit (International Monetary Fund, 2020).

Bankat komerciale u kanë ofruar kompanive, kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, forma të lehtësimit të procesit të huamarrjes, duke filluar nga grante deri te pushimet e pagesave dhe rristrukturimit të kredive.



**Figura 10.** Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Furnizimi me lëndë të parë/shërbime]

Para virusit COVID-19 nuk ka qënë e vështirë për të gjetur letër higjienike, miell dhe maska në dyqane apo në internet. Që kur filloi pandemia në Wuhan, Kinë, furnizimi dhe kërkesa për produkte në të gjithë botën kanë përjetuar një lëvizje të jashtëzakonshme. Shumë udhëheqësve të bizneseve u është dashur të menaxhojnë ndërprerje të konsiderueshme në zinxhirin e furnizimit dhe operacionet. Situata e krijuar nga pandemia ka çrregulluar zinxhirin e furnizimit të



bizneseve. 57.4% e respondentëve raportojnë se furnizimi me lëndë të pare apo shërbime është duke shkaktuar probleme serioze.



**Figura 11. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Kam humbur tregjet jashtë Kosovës]**

Vetëm 20% e bizneseve të anketuara janë eksportuese në tregjet e jashtme. Pandemia COVID-19 ka ndërprerë rrjedhën normale të ekonomisë globale dhe tregtisë botërore në një shkallë të paprecedentë. Rrjedha normale e tregtisë është ndikuar thellësisht ndërsa prodhimi dhe konsumi janë zvogëluar në të gjithë globin. Pasojat direkte janë reflektuar në humbjen e tregjeve të jashtme dhe rrjedhën e eksporteve. Ku 37.2% e kompanive kanë raportuar ndikim negativ.

Edhe pse Kosova ka një numër të vogël të kompanive eksportuese (rreth 5%) humbja e tregjeve të jashtme do të ndikojë negativisht në tregjet e jashtme. Kjo është manifestuar me anulimin të porosive nga kompanitë e tregjeve të jashtme. 38.8% e kompanive kanë raportuar se kanë ndërprerë kontratat me partnerët.




**Figura 12.** Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Pasiguria/Paftësia për të planifikuar biznesin]

Krizat si pandemia manifestohen me pasiguri që shkakton problem të planifikimeve në biznes.

Pandemia COVID-19 ka sjellur një epokë të re ndryshimi edhe për bizneset. Kompanitë i kanë ndjerë efektet e kësaj situatë me pasoja shumë të larta. Ndërsa për vendimmarrësit e kompanive ka qënë pothuajse e pamundur të parashikojnë dhe të bëjnë një vlerësim të saktë të rreziqeve dhe pasojave të mundëshme. 77.5% e respondentëve raportojnë se paftësia për të planifikuar si rezultat i pasigurisë ka pasur ndikim negative në biznese

Sapo të kalojë kërcënimi i menjëhershëm i virusit, kompanitë do të duhet të marrin në konsideratë ndikimin e këtyre ndryshimeve në mënyrën se si ne projektojmë, komunikojmë, ndërtojmë dhe drejtojmë përvojat që njerëzit kanë nevojë dhe duan.


Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Rrjedha e parasë (Paftësia për të paguar shpenzimet si pagat, qiraja, etj.)]



**Figura 13.** Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Rrjedha e parasë (Paftësia për të paguar shpenzimet si pagat, qiraja, etj.)]

Problemet me rrjedhjen e parasë janë evidente për shumicën e bizneseve. 86% e bizneseve kanë raportuar problem me rrjedhjen e parasë e cila do të reflektohet në vështirësitë e kompanive për të paguar shpenzimet operative si pagat, qiraja etj. Vendimet për investime ose punësime zakonisht janë pjesë e kostove fikse, të cilat nuk mund të rikuperohen, dhe kështu që kur pasiguria është e lartë, marrja e një vendimi të tillë ka peshë shumë më të rëndë deri në momentin që sigurohet që është vendimi ka qënë i duhur për të ndërmarrë këto kosto

**Si rezultat i klimës së krijuar nga Koronavirusi a e keni mbyllur biznesin ?**



**Figura 14.** Si rezultat i klimës së krijuar nga Koronavirusi a e keni mbyllur biznesin ?

Kriza e vazhdueshme COVID-19 ka pasur një ndikim shkatërrues në biznese kryesisht në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Masat e rrepta të ndalimit të lëvizjes të imponuara ka Qeveria e Kosovës bënë që shpenzimet e konsumatorëve të ulen drastikisht dhe të ardhurat të bien, pothuajse brenda natës, duke kërcënuar jetesën e rreth 67% përqind të bizneseve.

### 5.1.Ndikimi i COVID-19 në fuqinë punëtore




**Figura 15.** Nëse klima aktuale e biznesit si rezultat i Koronavirusit do të vazhdonte, sa kohë do të duhej që biznesi juaj të ketë ndikime të negative, siç është largimi i punonjësve nga puna?

Shfaqja e papritur e pandemisë COVID-19 ka shkaktuar që niveli i jo aktivitetit ekonomik dhe niveli i papunësisë në Kosovë të rriten. Mirëpo Kosova ka pasur nivele të larta edhe para pandemisë, në veçanti te papunësia e të rinjve, papunësia e grave dhe papunësia e të diplomuarve. Të dhënat nga Agjencia e Punësimit tregojnë se numri i punëkërkuesëve gjatë muajit prill të vitit 2020 është rritur me mbi 37 mijë persona të papunë. Fokusi i politikave qeveritare është në forcimin e kapaciteteve të stafit për kujdes shëndetësor meqënëse kërkesa për shërbime mjekësore ka shënuar një rritje të ndjeshme. Mirëpo në anën tjetër shqetësimet e punësimit me të cilat përballen puntorët e sektorëve tjerë po rriten vazhdimisht.

9.3% e ndërmarrjeve veçse kanë larguar punëtorë nga puna. Nëse pandemia COVID-19 vazhdon edhe për 3 muaj 64.4% e bizneseve nuk do mund ta përballojnë dhe rrjedhimisht do t'i përjashtojnë punëtorët nga puna. Vetëm 14% e respondentëve kanë deklaruar se nuk planifikojnë largimin e puntorëve nga puna. Mesatarja e punëtorëve të larguar nga puna si rrjedhojë e

shpërthimit të COVID 19 është gjashtë (6). Mesatarja e punëtorëve që parashihet të largohen nga puna si rrjedhojë e shpërthimit të COVID 19 dhe vazhdimit të kësaj situatë është njëzet e nëntë punëtorë (29).




**Figura 16. Vlerësoni ndikimin negativ ekonomik të Koronavirusit në biznesin tënd? [Qasja në fuqi punëtore (Mungesa e punëtorëve për shkak të sëmundjes, izolimit, kujdesit për fëmijët etj.)]**

Kjo është një krizë shëndetësore, para së gjithash. Është jetike dhe urgjente që fillimisht të sigurohet shëndeti dhe siguria e punëtorëve, veçanërisht e atyre në sektorët esencjal që përballen në mënyrë direkte me klientë në vendin e punës.

Bizneset në mbarë botën po përjetojnë një krizë të paparë të fuqisë punëtore. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet kanë hasur në vështirësi në planifikimin dhe menaxhimin e fuqisë punëtore për periudhat afatshkurtër dhe afatgjatë, pasi fuqia punëtore dhe komunitetet përpiqen të funksionojnë dhe performojnë, ndërsa përballen me një realitet të ri të shkaktuar nga pandemia në jetën e tyre të përditshme. Mbyllja e detyrueshme e qendrave për përkujdes ditor të fëmijëve dhe shkollave ka detyruar prindërit të marrin edhe rolin e mësimit duke e vështirësuar suksesin e performancës në punë. Pandemia ka shkatuar edhe mungesa më të mëdha të punëtorëve për shkak të infektimit me virusin COVID -19 dhe izolimit të detyruar. 72.9% e bizneseve kanë raportuar se mungesat e tilla kanë ndikim negativ në zhvillimin e aktivitetit të tyre biznesor

## 6. Paketat Stimuluese dhe Preferencat e Bizneseve

Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? Pushim Tatimor




**Figura 17. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Pushime tatimor (lirimi nga tatimet për një kohë të caktuar)]**

Në grupin e pyetjeve të fundit në lidhje me preferencat e bizneseve në lidhje me paketat e ndryshme stimuluese, pyetjet janë ndarë në disa kategori bazuar në preferencat e bizneseve. Kategoritë e preferencave të listuara në pyetësor janë: i) Pushimi Tatimor; ii) Shtyrje e Pagesës së Tatimeve; iii) Grante; iv) Pagesa Direkte për Mbulimin e Shpenzimeve të Punonjësve; v) Aktivizimi i mjeteve të Trustit- Fondit Pensional; vi) Përdorimi i Mjeteve të Privatizimit; vii) Lirimi nga Tatimet Komunale për një Afat të Caktuar (6 deri në 12 muaj); viii) Përkrahja dhe Inkurajimi i Bankave që të dhënen Kredive me normë Zero të Interesit.

Në pyetjen se nëse ndër paketat stimuluese të qeverisë to të ishte pushimi tatimor, 72.1% e bizneseve kanë deklaruar se kanë preferencë shumë të lartë, ndërsa 10.1% preferencë mesatare dhe 10.9% preferencë e lartë. Në tri optionet e pyetjeve del që, në fakt se një shumicë dukshëm e lartë preferon këtë lloj të paketës stimuluese. Ndërsa, 1.6% pushimin tatimor e kanë listuar si preferencë shumë të vogël, 1.6% preferencë e vogël dhe 3.9% e respondentëve pa përgjegje.


Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar bizneset dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? Shtyrje e pagesës së tatimeve



**Figura 18.** Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar bizneset dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Shtyrje e pagesës së tatimeve (Jo lirim nga pagesa e tatimeve)]

Shtyrja e pagesës së tatimeve (jo lirim nga pagesa e tatimeve) krahasuar me pushimin tatimor përnjë përqindja është më e ulët në krahasim me pushimin tatimor në pyetjen paraprake. Gjithsej 48.1% e bizneseve kanë listuar si preferencë shumë të lartë shtyrjen e pagesës së tatimeve, pëcjellur nga 17.1% që konsiderojnë si preferencë të lartë, ndërsa preferencë shumë e vogël si paketë stimuluese e konsiderojnë vetëm 9.3%. Si preferencë mesatare kanë listuar gjithsej, 10.1%, preferencë shumë e vogël 1.6%, preferencë e vogël 1.6% dhe pa përgjigje në lidhje me pushim tatimor janë 3.9%.

Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar bizneset dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? Grante




**Figura 19. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar bizneset dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Grante (pa kthim për biznese)]**

Ndër format tjera stimuluese për bizneset janë edhe Grantet. Krahasuar në pyetjen paraprake në lidhje me tatimet, Kjo formë e politikave stimuluese nga ana e qeverisë nga ana e respondentëve, konsiderohet si preferencë shumë e lartë gjithse me 71.3%. Një pjesë e respondentëve koniderojnë se grantet janë preferencë e lartë gjithsej 17.1%, dhe 1.6% si preferencë shumë e vogël, preferencë e vogël 8.0%, preferencë mesatare e kanë konsideruar 6.2% dhe pa përgjigje 3.1%.




Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU?  
Mbulimi i shpenzimeve të punetoreve



**Figura 20.** Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Pagesa direkte për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve]

Në krahasim preferencat e lartë përmendura, mbulimi i shpenzimeve të punëtorëve si formë e stimulimit të bizneseve nga ana e qeverisë është 79.8% e cila konsiderohet si preferencë shumë e lartë. Ndërsa, preferencë e lartë e konsiderojnë 10.9%, preferencë shumë e vogël 3.1%, preferencë mesatare 4.7% dhe në fund pa përgjigje janë 1.6% e bizneseve të deklaruara.


Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? Aktivizimi i mjeteve te trustit



**Figura 21.** Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Aktivizimi i mjeteve të Trustit- Fondit Pensional]


Për aktivizimin e mjeteve të trustit, për 46.5% të bizneseve është preferencë shumë e lartë, 17.8% është preferencë e lartë, 13.2% preferencë mesatare, ndërsa preferencë shumë e vogël 6.2% dhe preferencë e vogël 2.3%. Sa i përket kësaj forme të stimulimit nga ana e qeverisë, 14% nuk janë deklaruar fare e cila për nga përqindja është më e larta.

Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? përdorimi i mjeteve te privatizimit



**Figura 22.** Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Përdorimi i mjeteve të privatizimit]


Sa i përket përdormit të mjeteve të privatizimit si formë e stimulimit të qeverisë, 39.5% e bizneseve e konsiderojnë si preferencë shumë e lartë, përcjellur nga 19.4% që e konsiderojnë si preferencë e lartë, 12.4% si preferencë mesatare, dhe 3.9% e konsiderojnë si preferencë shumë e vogël dhe preferencë e vogël. Ndërsa 20.9% të bizneseve nuk janë deklaruar për këtë formë si preference për stimulim për bizneset e tyre.



**Figura 23.** Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar bizneset dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Lirimi nga tatimet komunale për një afat të caktuar (6 deri në 12 muaj)]

Sa i përket lirimit të tatimeve komundale nga 6 deri në 12 muaj, si formë e stimulimit të qeverisë, 60.5% e bizneseve e konsiderojnë si preferencë shumë e lartë, 20.2% konsiderojnë së është preferencë e lartë për bizneset e tyre, 7.0% preferencë mesatare, 3.9% preferencë shumë e vogël dhe preferencë e vogël e konsiderojnë 4.7%, ndërsa 3.9% janë pa përgjigje. Kjo formë e preferencës krahasuar me atë të tatimeve në nivel qendror është me e ulët dhe preferencat e bizneseve për stimulime nga ana e institucioneve ndërliden me nivelin qendror dhe jo atë lokal.

Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? Norma zero interesi permes bankave



**Figura 24. Aktualisht në vende të ndryshme por edhe në Kosovë janë duke u diskutuar disa ide për të ndihmuar biznest dhe ekonominë. Cilen nga këto mendoni se do të jetë më e dëshirueshme për JU? [Përkrahja dhe inkurajimi i bankave që të japini kredi më normë zero të interesi.]**

Forma e fundit e stimulimit të bizneseve nga ana e qeverisë është norma e interesit përmes institucioneve financiare, përkatësisht bankave. Sipas të dhënave 72.9% e bizneseve normat zero të interesit i konsiderojnë si preferenca shumë të larta, krahasuar me 14% që këtë formë të stimulimit e konsiderojnë si preferencë të lartë. Ndërsa sa i përket preferencave tjera, si preferencë shumë e vogël e konsiderojnë 3.9%, preferencë e vogël 4.7%, dhe preferencë mesatare 7% dhe në fund pa përgjegje 3.9%.

## 7.Përfundim

Të dhënat e kësaj ankete mbi pritjet e bizneseve janë shumë të rëndësishme për politikëbërësit e nivelit qendror dhe lokal në mënyrë që gjykimet e tyre në lidhje me masat që duhet ndërmarrë për të rimëkëmbjen ekonomisë së Kosovës të marrin për bazë opinionet dhe nevojat e vetë bizneseve.

Përballë kësaj situatë shqetësuese, prioritet i menjëhershëm për politikëbërësit duhet të jetë adresimi i krizës shëndetësore, lehtësimi i presionit direkt mbi profesionistët mjekësorë dhe frenimi i dëmit ekonomik afatshkurtër. Ndërsa për periudhën afatgjatë, qeveria në bashkpunim me institucionet e nivelit lokal duhet të hartojnë programe gjithëpërfshirëse në mënyrë që të përmirësohen disa nga faktorët themelorë që do mundësojnë një ekonomi më stabile vendore.

Institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal për të hartuar politika për periudhat afatshkurtëra dhe afatgjata duhet të përfshijnë rritjen e kapaciteteve njerëzore që ofrojnë shërbimeve shëndetësore dhe implementimin e masave stimuluese të synuara për rimëkëmbje ekonomike, duke përfshirë mbështetjen për sektorin privat dhe të papunësuarve.

Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mes rajonit dhe botës rreth masave të nevojshme për të ngadalësuar përhapjen e pandemisë dhe të veprimeve ekonomike të nevojshme për të lehtësuar dëmin ekonomik, risin gjasat për stabilizimin e shëndetit publik dhe mundësojnë një rigjenerim më të shpejtë të krizës globale. Fryma bashkëpunuese dhe prioritizimi i interesit të gjërë publik duhet të dominojë edhe në institucionet edhe në instucionet vendimmarrëse duke lënë menjëanë divergjencat politike.

## 8.Rekomandime

**Stimulimi i kërkesës agregate të konsumatorëve.** Simpas gjetjeve shitjet dhe kërkesa e klientëve janë ulur në mënyrë drastike. Andaj rekomandimi i parë për institucionet qendrore dhe lokale do të ishte stimulimi i kërkesës agregate të konsumatorëve në mënyrë që të rritet apo edhe stabilizohet fuqia blerëse e konsumatorëve. Kjo mund të bëhet edhe përmes subvencionimit të pagave (ndër preferencat e bizneseve 79.8%) për punëtorët e bizneseve që rrezikohen të mbyllen si rezultat i pandemisë.

**Stimulimi i bizneseve përmes tatimeve (pushimi tatimor).** Duke u bazuar në gjetjet, rrjedha e parasë së bizneseve ka shënuar rënie deri në 86.%, po ashtu edhe ulja e investimeve 78%. Përbushja e obligimeve tatimore të bizneseve është ndikuar nga pandemia, ku rrjedhja (gjithsej 86%) ka shënuar rënie bashk me të edhe investimet e planifikuara (gjithsej 78%). Andaj përmes, pushimit tatimor bizneset do të inkurajoheshin të ri-planifikonin investimet dhe do të krijojnë stabilitet financiar.

**Normat e interesit të bankave, si formë e stabilitetit të bizneseve dhe inkurajimit të firmave për investime afatgjate.** Normat zero të interesit, përmes ndërmjetësimit të qeverisë si formë e stimulimit do të ndikojë pozitivisht në krijimin e një klime më të favorshme për investime. Kostoja e lartë e normave të interesit, ndikon negativisht në vendimet e bizneseve për planifikime të investimeve qoftë në zgjerimin e kapaciteteve aktuale apo në investime në kapacitete tjera të reja. Sepse, aftësia për të paguar kredi e bizneseve është ulur dukshëm, që ndërlidhet e rënie e shitjeve dhe rrjedhën e parasë. Kjo formë e stimulimit rekomandohet të ndahet sipas rrezikshmërisë së sektorëve/industri, po ashtu edhe rëndësisë strategjike të tyre.

**Qasja në fuqi punëtore, krijimi i kushteve më të mira të punës, dhe investime në fuqi punëtore të kualifikuar.** Si pasë të dhënave të anketës, qasja në fuqi punëtore në kohë pandemie ka qenë njëra ndër problemet kryesore të bizneseve, që ndërlidhet edhe me masat e ndërmarra nga ana e qeverisë për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Andaj, përmes krijimit të kushteve më të mira të punës për parandalimin e infektimit të fuqisë punëtore, nevojitet edhe një kordinim më i madh i nivelit qendror-lokal dhe biznese. Në kuadër të kësaj, në aspektin afatgjatë përmes skemave të ndryshme të ministrive dhe departamenteve përkatëse të pregaditet aftësimi i fuqisë punëtore në mënyrë të rritet produktiviteti i firmave dhe kualiteti i shërbimeve që ofrojnë.

Prioritet i menjëhershëm për politikëbërësit duhet të jetë adresimi i krizës shëndetësore, lehtësimi i presionit direkt mbi profesionistët mjeksorë dhe frenimi i dëmit ekonomik afatshkurtër. Ndërsa për periudhën afatgjatë, qeveria në bashkpunim me institucionet e nivelit lokal duhet të hartojnë programe gjithëpërfshirëse në mënyrë që të përmirësohen disa nga faktorët themelorë që do mundësojnë një ekonomi më stabile vendore.

## Referencat

Donthu, N. &. (2020). Effects of COVID-19 on business and research. *Journal of business research*, 117, 284.

International Monetary Fund. (2020, October 8). *Kosovo: Staff Concluding Statement of the 2020 Article IV Mission*. Gjetur 2020, nga International Monetary Fund: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/10/08/mcs100820kosovo-staff-concluding-statement-of-the-2020-article-iv-mission>

Kluge, D. H. (2020, March 12). *WHO announces COVID-19 outbreak a pandemic*. Gjetur December 2020, nga World Health Organization Europe: <https://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/news/news/2020/3/who-announces-covid-19-outbreak-a-pandemic>

LIGJI NR. 07/L-016. (2020, December 17). *LIGJI NR. 07/L-016 PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE - COVID-19*. Gjetur 2020, nga Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=35478>

Ministria e Financave. (2020). *Bruto Produkti Vendor*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Morgan, T. A. (2020). SME response to major exogenous shocks: The bright and dark sides of business model pivoting. *International Small Business Journal*, 369-379.

Van Assche, A. &. (2020). From the editor: COVID-19 and international business policy. *Journal of International Business Policy*, 273–279.

Zyra e Kryeministrit. (2020, March 30). *Vendim*. Gjetur 2020, nga Zyra e Kryeministrit: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>